

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"GREEN STEP" Sh. P. K.**

Në Tiranë më datë 21 Shkurt 2017(dymijë e shtatetëmbëdhjetë) ditën e martë, unë i nënshkruari **Ilir Latifi** i biri i Mujos dhe Havas lindur më 14.10.1978 banues në Tirane, i paisur me pasaporten angleze nr.651829672 *me cilësinë e ortakut të vetëm dhe, me vullnetin tim të lirë e të plotë vendosa tē krijoj shoqërinë me përgjegjësi tē kufizuar me emërtimin "GREEN STEP" Sh.P.K.* me Qendër në Tiranë, Rr. "Hamdi Garunja", prane liqenit te thatë,Kompleksi Fusha, Kati I-rë, 1060.

**Neni 1  
EMËRTIMI DHE QENDRA E SHOQËRISË**

**EMËRTIMI : "GREEN STEP". Sh.P. K.**

**SELIA:** Tiranë, Rr. "Hamdi Garunja", prane liqenit te thatë,Kompleksi Fusha, Kati I-rë, 1060.

Shoqëria do tē jetë Person Juridik me regjistrimin në Q.K.B. sipas nenit 22 të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" e në bazë të Ligjit Nr 9901 të datës 14.04.2008 "PËR TREGËTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE". Shoqëria do tē gëzojë tē gjithë tē drejtat si peson juridik dhe do tē fillojë veprimtarinë e saj nga data e regjistrimit në Q.K.B.

**Neni 2  
QËLLIMI I SHOQËRISË**

*Shoqëria ka për objekt zhvillimin e këtyre aktiviteteve me objekt si vijon:*

- Investime në sektorin bujqesor dhe blegtoral te te gjitha llojeve.Investimi ne agrikulture dhe turizem.
- Trajtimi dhe perpunimi dhe shfrytezimi i pasurive tē paluajtshme me qellime kthimin e tyre ne toka pjellore per pemtari, ullishte dhe agrikulture dhe turizem duke perfshire dhe proceset ndertuese mbi dhe nen toke.Blerje, shitje, marrje dhe dhënie me qira e në huapërdorje ose në çfarëdo lloj forme tjetër tē pasurive tē paluajtshme
- Sipermarrja e krijimit te infrastruktura se perpunimit te ullirit dhe prodhimeve te tjera bujqesore dhe blegtoriale, si dhe shitja, importimi dhe eksportimi i ketyre produkteve dhe makinerive te nevojshme per realizimin e tyre.Krijimin e zyrave dhe ambjenteve te nevojshme per perpunimin, ekspozimin dhe kryerjen e operacioneve te ndryshme te sipercituara;
- Veprimtari të tjera tē cilat nuk bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe që kanë lidhje tē drejtpërdrejtë me aktivitetin e lartpërmendor.
- Ofrimi i shërbimeve te ndryshme ne sektorin e hoteleri-turizmit, bar-resorante dhe shërbime social-kulturore. Ndertim dhe rikonstruksion objektesh turistike, industriale, civile, bujqesore, te te gjitha llojeve, rrugeve automobilistike, urave, kanalizimeve dhe veprave te tjera ujitese.



- Punime dhe sistemime terrenesh, prodhime te materialeve inerte, prodhime te elementeve te parafabrikuara te gjitha llojeve dhe instalime te nevojshme per te gjitha llojet e objekteve. Instalime elektrike, hidraulike, skela dhe procese te tjera ndertuese.
- Eksport-import, tregtim me shumice dhe pakice i: Mallrave industriale te çdo lloji, tekstile, konfeksione, produkte plastike, prodhime prej qelqi e xame, metale, druri, prodhime metalike, materiale ndertimi, aksesoret e llojeve te ndryshme, kompjutera dhe paisjet e tjera elektronike dhe kancelarike, mallra ushqimore e blegtorale, fruta e perime te fresketa e te konservuara, lengje frutash, pije freskuese e alkolike, pije energjitike si dhe :
- Energji elektrike, gaz natyror, hidrokarbure me pakice. Makineri e pajisje te çdo lloji, vegla pune, materiale e pajisje elektronike dhe elektrike, materiale e lendet e pare per ndertim, konstruktione metalike, etj. Artikuj dhe materiale te ndryshme sportive. Automjete e pjese kembimi per to, si dhe sherbime autosevisi etj.
- Prodhimi, amballazhimi, konservimi dhe tregtimi me shumice e pakice i birres dhe pijeve te tjera alkoolike, lengje frutash, pije freskuese, etj. Prodhimi, amballazhimi, konservimi dhe tregtimi me shumice e pakice i ujrale minerale dhe natyrale. Perpunimi i drurit, prodhimi i orendive, pajisjeve, mobiljeve dhe aksesoreve te ndryshem dhe tregtimi i tyre. Importim i gomave te reja dhe te perdonura per çdo lloj automjeti. Import, eksport, depozitim dhe tregtim me shumice e pakice i barnave, ilaçeve dhe produktave farmaceutike. Transport automobilistik dhe te kombinuar te mallrave dhe udhetareve brenda dhe jashtë vendit me mjete te veta ose te te treteve per vehte dhe te trete. Ofrimin e sherbimeve te te gjitha llojeve,

*Ky aktivitet do të zhvillohet në fushën internacionale dhe në atë nacionale “.*

Si objekt të veprimtarisë së saj shoqëria do të ketë edhe kryerjen e çdo operacioni ekonomik dhe juridik të lejuar nga legjislacioni shqiptar, që përputhet me objektin e veprimtarisë së saj dhe që kanë rëndësi për të ardhmen e shoqërisë.

### Neni 3 REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË

“Shoqëria”, në veprimtarinë e saj bazohet në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri tregëtare krijohet me objektivin për të vazduar veprimtarinë për një periudhë kohore pa afat.

Me vendim të “Ortakut”, mund të ndryshojë rregjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas Legjislacionit Shqiptar. Në këtë rast “Ortaku” do ta përshtasë “Kontratën e Themelimit” dhe “Statutin e Shoqërisë”, si dhe rregjistrimin e tyre nga organet kompetente Shqiptare.

“Shoqëria” gëzon personalitet juridik nga dita e miratimit dhe e regjistrimit të saj në regjistrin tregëtar në **Q.K.B.**

“Shoqëria” mund të ketë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në përputhje me dispozitat e Legjislacionit Shqipëtar. Pasuria mbrohet sipas dispozitave të ligjit ne fuqi.

**“Shoqëria” do të ketë vulën e saj të cilën do ta caktojë me Vendimin e Ortakut të Vetëm.**

*Neni 4*  
**KAPITALI – THEMELTAR**

Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Bashkëzotërueshit e një kuote, sipas nenit 72, të ligjit 129/2014, gjëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm.

Kapitali i Shoqërisë, në tërësi zotërohet nga “Ortaku i vetëm” **Ilir LATIFI**, i cili ka formuar kapitalin fillestar të shoqërisë ne vleren prej **2.000.000 lekë -- (dy milion)**, me një kuote me vlerë nominale **2.000.000 lekë** kuota. Shtesa e kapitalit themeltar, vendoset me vendim të ortakut të vetëm.

Nga momenti i vendosjes së kontributit në kapitalin themeltar të Shoqërisë, Shoqëria fiton të drejtën e pasjes, përdorimit dhe disponimit të këtij elementi pasuror, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe urdhërimet e këtij **Akt Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë**.

Shtesa e kapitalit themeltar, vendoset me vullnetin e ortakut të vetëm. Kapitali themeltar mund të shtohet në vartësi të aktivitetit, nga kontributet plotësuese të ORTAKËVE (*në rast ndryshimi/shtimi të Ortakëve*), sipas përqindjes së tyre në këtë kapital, me përjashtim të rasteve kur vendoset unanimisht e kundërtat.

Shtesa e kapitalit themeltar, vendoset me vendim të Ortakut të vetëm.

Kapitali i shoqërisë i kontribuar nga çdo ortak do të regjistrohet në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

*Neni 5*  
**DREJTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria drejtohet nga këto organe:

→ Nga Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë.

→ Mënyra e emërimit dhe kompetencat e tij përcaktohen nga statuti i shoqërisë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Në kuptim të këtij Akti—themelues, **Ortaku i vetëm i shoqërisë është Ilir Latifi**

Detyrën e Administratorit të Përgjithshëm do ta kryejë, për një afat kohor **5-vjeçar**, nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, vetë Ortaku i vetëm i shoqërisë **Z.Ilir Latifi**



## Neni 6

### PËRFAQËSUESI LIGJOR / ADMINISTRATORI

Ortaku i vetëm vendos që Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë të jetë **Z. Ilir Latifi**. Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, mund të kryejë të gjitha veprimet ligjore që janë në interes të shoqërisë në përputhje me Statutin e Aktin e Themelimit të saj.

Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, do të ketë autoritet të përgjithshëm në aktivitetin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe ka të drejtën e marrjes se çdo ndërmarrje dhe çdo veprimi që konsiderohet i nevojshëm për realizimin e qëllimit të shoqërisë me përjashtim të rasteve që ligji “Mbi Tregëtaret dhe Shoqëritë Tregëtare” i kufizon. Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, ka të drejtë t'i propozojë mbledhjes së Asamblese së Ortakëve (*në rast ndryshimi/shtimi të Ortakëve*) planin e mbledhjeve duke marrë vendime për zhvillimin e veprimitarive të shoqërisë, duke përcaktuar dhe linjat kryesore të veprimitarise së shoqërisë.

Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët për përbushjen e aktivitetit te saj në perputhje me parashikimet në statutin e kësaj shoqerie.

Organit Administrativ Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë.) është kompetent për të:

- realizuar mbledhjen e Asamblessë duke njoftuar (ortakët kur ka) me shkrim 15 ditë me parë;
- miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- Te marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të vecanta), ndarjen e fitimit, etj.
- përfaqësuar apo emëruar përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria;
- emëruar përfaqësues duke i deleguar të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij.


## Neni 7

### BILANCI, VEPRIMTARIA EKONOMIKE, DETYRIMET

Shoqëria mban përgjegjësi për të gjitha detyrimet shtetërore, sigurimet shoqërore etj. Ortaku i vetëm themelues ose persona të tjerë të autorizuar prej tij kanë të drejtë që me nxjerrjen e bilanceve ekonomike, çdo fund-viti kalendarik, të përfitojnë përqindjet e realizuara nga veprimitaria private.

Shoqëria "Green Step" sh.p.k ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Të gjitha mosmarëveshjet me persona fizikë ose juridike, vendas ose të huaj si dhe organet shtetërore, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



**Neni 8**  
**KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Afati i veprimtarisë të kësaj Shoqërie është *pa afat të caktuar*, por aktiviteti fillon nga data e nënshkrimit të këtij akti. Afati i funksionimit të Shoqërise është afati i veprimit të Akt—Themelimit, që fillon nga data e regjistrimit në QKB.

**Neni 9**  
**LIKUIDIMI I SHOQËRISE**

Rastet dhe procedura e likuidimit të Shoqërise, si dhe mbarimi i Afatit të Aktit të Themelimit të Shoqërise përcaktohen në Statutin e saj.

**Neni 10**  
**DISPOZITA të PËRGJITHSHME**  
*Ndryshime të favorshme në Legislacionin Shqipëtar*

Ky Akt—Themelimi i Shoqërisë ka si aneks Statutin e Shoqërisë. Çdo ndryshim dhe shtesë e këtij Akt—Themelimi, si dhe e Statutit, bëhet me Vendim të Ortakut të vetëm. Në qofte se në Republikën e Shqipërisë shpalen ligje, dekrete, ose vendoset një politike më e favorshme nga Legjislacioni ekzistues gjatë kohës së vendosjes së shoqërisë, atehere “Ortaku”, ka të drejtë t’i drejtohet organeve përkatëse shtetërore që të zbatojnë legjislacionin më të favorshëm.

Çështjet e pa mbuluara nga ky statut do të rregullohen nga legjislacioni Shqipëtar dhe ne veçanti nga Ligji Nr.9901 dt 14.04.2008 ,Mbi Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare“.

Ky Akt—themelimi nënshkruhet në Tiranë dhe hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM  
"Green Step" sh.p.k

**Z. Ilir Latifi**

